

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Fabjan Peka, shqiptari që u përball me Ramën gjatë fluturimit
ADRESA	https://joq-albania.com/artikull/1391684.html
BURIMI	joq-albania.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	14 shtator 2026, 22:59:59 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
LEXUAR NGA FAQJA	14 shtator 2026, 22:54:00 UTC <i>Portali nuk e deklaroi datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me meto dën text_date. Dritarja: 14 shtator 2026, 22:53:00 UTC → 14 shtator 2026, 22:55:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund t ë gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	56696bfcfea42a2801d8d0f8d1666943d76910558ceee8dfcf6ce9991df75ae3
TEKSTI	0292d79c2ff24e28a5fe277c2305fd149927b055cf971d024c30606a9e62a093
PAMJA	d35ffac445f7fcb5e32d68f5dd85834510b609d091778ddcddd00e0c0651898e

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f5db574be37fa4c448138a6556d0009bb533b789d7b861e31b09d06a5ca07ee2
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8729c79851275621b4c6c44d242b28351d5ca56156a65ed2ec91bb9b8f9753f7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/f5db574be37fa4c448138a6556d0009bb533b789d7b861e31b09d06a5ca07ee2>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fabjan Peka, shqiptari që u përball me Ramën gjatë fluturimit

Shkruar nga: V Gashi | Publikuar më: 15.09.2026, 00:54



Share



Share



Personi që shihni në foto është Fabjan Peka, shqiptari që u përball këtë të hënë me kryeministrin Edi Rama gjatë fluturimit me linjën Tiranë-Napoli dhe që më pas u shoqërua nga policia italiane.

Pak orë më parë, JOQ Albania publikoi ekskluzivisht një video të dërguar në redaksi nga një qytetar, i cili ndodhej si pasagjer në avionin me të cilin Rama udhëtoi drejt Napolit.

Në pamje, Rama dhe i riu shihen duke zbritur së bashku nga shkallët e avionit. Gjatë zbritjes, kryeministri shihet teksa i vendos dorën në pjesën e qafës së të riut dhe vijon ta mbajë deri në fund të shkallëve, ku ndodhen efektive të policisë italiane. Menjëherë pas zbritjes, Rama ia dorëzon të riun policëve, të cilët e shoqërojnë drejt një automjeti.


Në videon e siguruar nga JOQ Albania nuk dëgjohet komunikimi mes tyre, ndaj nuk mund të përcaktohet nga pamjet se çfarë i është thënë kryeministrit apo çfarë ka ndodhur përpara momentit të filmuar.

Sipas dëshmitarit që na dërgoi videon, Fabjan Peka e ka sharë Ramën gjatë zbritjes nga avioni. Ndërkohë, në media po qarkullon edhe një tjetër version, sipas të cilit i riu i ka thënë kryeministrit: "Shpresoj të mos kthehesh më në Shqipëri".

Pikërisht për këtë pjesë, JOQ Albania i bën thirrje Fabjan Pekës të na kontaktojë dhe të japë versionin e tij për atë që ka ndodhur. Nëse dëshiron, redaksia jonë është e gatshme t'i japë hapësirë të plotë për të shpjeguar se çfarë i ka thënë Ramës, çfarë ka ndodhur në avion dhe përse u shoqërua nga policia italiane.

Në këtë mënyrë, përtej asaj që shihet në video dhe dëshmisë së pasagjerit që e dërgoi atë, vetë personi që ndodhet në qendër të ngjarjes ka mundësinë të tregojë se si qëndron e vërteta.

Fabjan Peka, i riu që pati guximin të përballej me Ramën gjatë fluturimit, është gjithashtu kushëri i gazetarit Çim Peka.



Më të Lexuarat



ARTIKULL JOETIK?

JOQ Albania mbetet e hapur për reagimin e Fabjan Pekës dhe do ta publikojë versionin e tij, nëse ai vendos të kontaktojë redaksinë.

FACT CHECK: Synimi i JOQ Albania është t'i paraqesë lajmet në mënyrë të saktë dhe të drejtë. Nëse ju shikoni diçka që nuk shkon, jeni të lutur të na e [raportoni këtu](#).

JOQ Sondazh
KLIKO PËR TË VOTUAR

TË NGJASHME

Më të fundit



Dërgo materialin tënd këtu >

Puno me ne!

Marketing

Politika e privatësisë

Rreth Nesh

Kushtet e përdorimit

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.